

GJUHËSIA SHQIPTARE KUNDREJT PËRDORIMIT ZYRTAR TË GJUHËS SHQIPE NË RVM

Zeqirija IBRAHIMI¹

¹* Institute of Spiritual and Cultural Heritage of the Albanians – Skopje

*Corresponding author e-mail: zibrahimi@yahoo.com

1. Shpjegime hyrëse

Në kuadër të gjuhësisë është zhvilluar edhe një disiplinë gjuhësore, që është emërtuar si Gjuhësia e zbatuar (*Applied Linguistics*), e cila merret me studimin e aplikimit të gjuhës në shoqëri, duke i studiuar problemet reale gjuhësore në shoqëri dhe duke ofruar zgjidhje për to. Ajo është një fushë interdisiplinore e gjuhësisë, që – pos tjerash – merret edhe me *planifikimin e gjuhës ose politikat gjuhësore*.

Këto dy nocione, që do të përdoren dendur në këtë tekst, edhe pse shpesh hasen si sinonime ose pranë njëri-tjetrit, kanë edhe kuptimet e tyre të dallueshme. Bernard Spolsky në studimin përmbledhës prestigjioz dhe bashkëkohor të Universitetit të Kembrixhit “*Language policy*”, ku janë përfshirë një mori tekstesh të kësaj fushe, thotë se: “*Planifikimi i gjuhës është ndryshim i qëllimshëm i gjuhës, ndryshim në sistemet e kodit gjuhësor ose të folurit ose të dyja ato dhe bëhet nga organizatat që janë krijuar për qëllime të tilla ose u është dhënë një mandat që të përmbushin qëllime të tilla. Si i tillë, planifikimi i gjuhës është përqendruar në zgjidhjen e problemeve dhe karakterizohet nga formulimi dhe vlerësimi i alternativave për zgjidhjen e problemeve gjuhësore. Ai gjithnjë është i orientuar drejt së ardhmes, duke specifikuar politikat dhe strategjitë përpara veprimit që duhet të ndërmerret.* (Spolsky, *The Cambridge Handbook of language Policy*, 2012, f. 16).

Ndërkaq, Prof. Rexhep Ismajli në veprën “*Në gjuhë dhe për gjuhë*”, në lidhje me termin *planifikim gjuhësor* krijon një citat të parafrazuar të disa gjuhëtarëve (Weinstein, Wardhaugh, Byron), duke thënë se: “*Planifikimi i gjuhës është përpjekja e autorizuar, afatgjatë, e mbështetur dhe e vetëdijshme për të ndryshuar funksionin e gjuhës në shoqëri me qëllim të zgjidhjes së problemeve të komunikimit*” (Ismajli, 1998, f. 19)

Në frymë të kësaj është edhe gjuhëtari Jean Dubois, të cilit i referohet prof. Bahri Beci, sipas të cilit me politikë gjuhësore kuptojmë “*tërësinë e masave dhe të projekteve ose strategjinë që ka për qëllim ta rregullojë statusin dhe formën e një gjuhë ose të shumë gjuhëve*” (Beci, 1999, f. 13).

J. Byron, e cila u referohet autorëve Jernudd dhe Das Gupta, thotë se: “*Planifikimi nënkupton që vendimmarrësit zgjedhin një linjë veprimi të pranueshme ose edhe optimale, por gjithmonë brenda mundësive dhe burime materiale e njerëzore në dispozicion dhe vetëm në funksion të arritjes së qëllimeve të miratuara nga autoritetet politike*” (Byron, 2012, f. 31).

Gjuhëtari Milorad Radovanović thotë se, ndonëse këto dy terma përdoren si sinonime, kuptimi i tyre është se “*planifikimi i gjuhës nënkupton veprimin mbi gjuhën*”, ndërsa “*politika gjuhësore nënkupton veprimin me gjuhën*” (Radovanović, 2004, f. 28). Meqë nuk pretendojmë se kemi mandat ose autorizim, opinioni i dhënë në këtë tekst më shumë synon të jetë një propozim-projekt për një planifikim gjuhësor, që mbase edhe mund të shërbejë për një politikë gjuhësore nga institucionet e autorizuar me këtë detyrë. Prandaj, termi ynë i preferuar në këtë tekst do të jetë *planifikimi gjuhësor*.

Një nocion tjetër që duhet shpjeguar është emri i shtetit – hapësirës ku është vendosur çështja e shtruar. Në tekst herë është përdorur emërtimi “Republika e Maqedonisë” dhe herë “Republika e Maqedonisë së Veriut. Kjo është për arsye se kur i referohemi gjendjes para Marrëveshjes së Prespës (17 qershor 2018), e përdorim “Republika e Maqedonisë” ose vetëm “Maqedonia”, ndërsa kur flasim për kontekst pas kësaj date, pra pasi që u ndryshua emri i shtetit, e përdorim “Republika e Maqedonisë së Veriut”, “Maqedonia e Veriut” ose, si shkurtesë, RMV.

2. Konteksti shoqëror

Më 11 janar 2018 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhëve, që me shënimin e dhënë në kllapa “gjuha shqipe” nënkupton se ai i referohet gjuhës shqipe. Me këtë ligj, për herë të parë në vendin tonë, është bërë zgjerimi i mundësisë së përdorimit të shqipes zyrtare në organe të pushtetit presidencial, ekzekutiv, legjislativ, gjyqësor, lokal, si edhe në komunikim ndërkombëtar, në ushtri, në polici dhe në monedha, por edhe në veprimtari të tjera (i mbikëqyrur për herë të parë nga institucione për mbrojtjen e gjuhës – Agjencia për Zbatimin e Gjuhës dhe Inspektorati për Zbatimin e Gjuhës).

Për hir të së vërtetës, as ky ligj – në kuptimin juridik – nuk e ka bërë Maqedoninë e Veriut një shtet dygjuhësh (pranimi i dygjuhësisë implikon ndryshimin e kushtetutës, përcaktimin e kombit shqiptar si komb i dytë dhe pastaj reflektimin e këtij formulimi në normë ligjore që i referohet gjuhës) sipas modelit të shteteve që në mënyrë institucionale e aplikojnë shumëgjuhësinë (Siguan, 2004, f. 56-57), por ka krijuar një situatë gjuhësore gati hibride – me këtë ligj gjuha shqipe nuk është më në grupin e gjuhëve të pakicave në RMV, as nuk është bërë e barabartë me gjuhën maqedonase, por as nuk ka marrë ndonjë status tjetër të konkretizuar si “gjuhë e dytë zyrtare”.

Ajo që është bërë me këtë ligj, në kuptimin formal, është zgjerimi i përdorimit të saj në organe të pushtetit ku përdoret vetëm maqedonishtja, edhe pse gjithnjë e lidhur për të, por larg mundësisë që e kanë gjuhët e bashkësive më të vogla etnike, të cilat mund të përdoren vetëm në institucione të pushtetit lokal. Sidoqoftë, edhe pse precizimi i kësaj gjendjeje gjuhësore sigurisht do ta lehtësonte edhe *planifikimin gjuhësor* dhe *politikën gjuhësore* të Maqedonisë së Veriut, në kushtet në të cilat jemi para nesh shtrohen detyra të reja për përdorimin e gjuhës shqipe në komunikimin zyrtar.

Dhe, ky moment vërtet ka hapur një mundësi të re për shqiptarët në RMV, por kjo njëherazi e ka përballur gjuhësinë shqiptare në vendin tonë, por edhe më gjerë, me gatishmërinë e saj reale për të ofruar zgjidhje për të gjitha kërkesat dhe mundësitë që i ka krijuar ky ligj. Nuk ka ditë që ndonjë gjuhëtar të mos zbulojë një gabim në përdorimin e gjuhës shqipe në publik, gjë që përveçse flet për gjendjen reale të njohjes së shqipes nga përdoruesit e saj, flet edhe për nevojën që gjuhësia shqiptare në vendin tonë, por jo vetëm, të japë përgjigje për këto nevoja, të ofrojë zgjidhje të përgjithshme dhe të ofrojë një planifikim gjuhësor kundrejt këtyre kërkesave.

Ne mendojmë se nuk është e mjaftueshme që gjuhëtarët të gjejnë gabime, që i prezantojnë në punimet e tyre ose në shtyp, ndërsa përkthyesit dhe autorët e teksteve të tilla të mos komunikojnë me ato tekste dhe gjendja të vazhdojë. Qëndrimi ynë është se ky problem kërkon një zgjidhje parimore dhe thelbësore, frytet e së cilës do të reflektohen pastaj në përdorimin e gjuhës.

3. Planifikimi i përdorimit të gjuhës shqipe në RMV

Në librat për planifikimin e gjuhës/politikës gjuhësore janë dhënë disa kërkesa që duhet të ndiqen për të arritur shkallën e përdorimit të një gjuhë në nivel zyrtar (Radovanović, 2004, 64). Së pari duhet të bëhet *përzgjedhja*. Pra, duhet të dihet se cila është ajo gjuhë që duhet të ngrihet në nivel të përdorimit zyrtar. (Në këtë pikë ne nuk kemi dilemë – ajo është gjuha standarde shqipe e miratuar në Kongresin e Drejtshkrimit në Tiranë më 1972.) Pika e dytë është *përshkrimi* dhe *përcaktimi* i asaj gjuhe – cila është ajo gjuhë, cilat janë rregullat e drejtshkrimit e drejtshqiptimit të saj, cili është leksiku e fjalorët e saj, cila është gramatika e saj, cilat është frazeologjia e saj etj. dhe, përveç kësaj, pse zgjidhet pikërisht ajo gjuhë ose ai variant gjuhësor?

Kërkesa e tretë është *pranimi* i saj, që synon të përcaktohet se sa është ajo e pranishme dhe e pranuar nga folësit e saj në një rajon ku duhet të zyrtarizohet, pra cilat janë qëndrimet rreth pranueshmërisë së saj në një mjedis. Pika e katërt është *zbatimi*, që do të marrë në shqyrtim mundësitë ligjore, akademike dhe reale të zbatimit të saj në komunikim zyrtar. Pika e pestë është *përhapja dhe kultivimi*, që nënkupton mundësinë që ajo gjuhë/variant (në rastin tonë: gjuha standarde shqipe) të përhapet sa më shumë në shoqëri në kuptim të përdorimit sa më të gjerë të standardit të përcaktuar.

Këtu përfshihen edhe të gjitha burimet/resurset dhe mundësitë që ajo gjuhë të kultivohet si gjuhë zyrtare. Në të gjashtën e kemi *evaluimin*, pra vlerësimin e vendimit që është marrë dhe (mos)suksesin e arritjes së synimit për përhapjen, pranimin, zbatimin dhe kultivimin e saj. Dhe, në fund është *përmirësimi*, që nënkupton se institucionet akademike e kanë për detyrë që, pas *evaluimit* të bërë, të mund të japin këshilla e propozime se çfarë ka qenë e qëlluar, çfarë është gabuar dhe me çka mund të përmirësohet përdorimi zyrtar i gjuhës përkatëse.

Në kontekstin e kriterëve të planifikimit të gjuhës, duke folur për mënyrën se si ndërtohen politikat gjuhësore, prof. Rexhep Ismajli i referohet gjuhëtarit frëng Cobarrubias, i cili i përcakton katër tipa ideologjisë që motivojnë marrjen e vendimeve për planifikimin e gjuhëve: 1) *asimilimi gjuhësor* (shteti e imponon gjuhën e shumicës si gjuhë dhe kod të vetëm të komunikimit, madje duke synuar që të gjithë të asimilohen në atë gjuhë e më pas ta ndryshojnë edhe identitetin etnik – p.sh. Greqia ndaj komunitetit arvanit në shtetin grek); 2) *pluralizmi gjuhësor* (shteti pranon shumë se një gjuhë në komunikimin zyrtar – p.sh. Belgjika, Kanadaja, Zvicra); 3) *vernikularizmi gjuhësor* (ngritja e një gjuhe autoktone në rrafsh të gjuhës zyrtare – këtu e kemi përcaktuar edhe shqipen në RMV) dhe 4) *internacionalizmi gjuhësor* (një gjuhë ndërkombëtare joendase merret dhe ngrihet në rrafsh të përdorimit zyrtar – p.sh. anglishtja në Singapor, frëngjishtja në Tunis etj.).

Para se të flasim për mënyrat dhe mundësitë e planifikimit të shqipes në RMV, duhet të theksojmë se në këtë shtet kemi një tendosje ndërmjet dy bashkësive më të mëdha etnike (maqedonasve dhe shqiptarëve). Siç e dimë, maqedonasit dëshirojnë ta ruajnë monopolin e trinitetit shteti-kombi-gjuha (sipas modelit të Serbisë etj.), duke konsideruar se Maqedonia vazhdon të mbetet shtet njëgjuhësh që i njih gjuhët e pakicave (Siguan..., 2004, f. 56-57), siç shprehet edhe prof. Vllado Kambovski, se “*Maqedonia është definuar si shtet i kombit maqedonas dhe i të gjithë qytetarëve të saj që jetojnë në të*” (Камбовски, АСНОМ и Македонската држава, 2014, f. 13), ndërsa shqiptarët konsiderojnë se Maqedonia tashmë e njih një komb të dytë (kombin shqiptar)

dhe një gjuhë të dytë në përdorim zyrtar, pra gjuhën shqipe. (Ky ndryshim i gjendjes gjuhësore ka ndodhur me Marrëveshjen e Ohrit, që u nënshkrua më 13 gusht 2001, pas konfliktit të armatosur të shqiptarëve dhe forcave shtetërore.) Në interpretim shkencor i bie të themi se kjo gjendje gjuhësore është krijuar për shkak të nevojës së shqiptarëve në RMV për ta theksuar identitetin e tyre etnik, që në termat e Sue Wright-it, në doracakun e Kembrixhit, do të ishte prezantuar nën titullin “Politika gjuhësore, kombi dhe nacionalizmi” (Wright, The Cambridge Handbook of language Policy, 2012, f. 59-78).

Duke i parë rrethanat shoqërore politike në RMV, nuk mund të shpresohet se ky ngërç mund të zgjidhet me një dakordim të dy palëve, së paku jo shumë shpejt, por kjo nuk duhet të jetë pengesë për shqiptarët në këtë shtet që të sillen me gjuhën shqipe sikur ajo të jetë gjuhë e dytë zyrtare dhe ta planifikojnë përdorimin e saj duke e marrë këtë si fakt të kryer. Aq më shumë që pushteti, i drejtuar rëndom nga shumica maqedonase nuk ka ndonjë interes për këtë temë dhe prandaj kjo mbetet një punë që duhet ta shtyjnë shqiptarët me fuqinë e tyre.

Në të vërtetë, pas themelimit, më 14 janar 2019 (apj.gov.mk/historiku/?lang=sq – 31.12.2020), të Agjencisë për Zbatimin e Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut (kështu është emri zyrtar, ndërsa në opinion njihet si Agjencia për Zbatimin e Gjuhës e RMV-së), janë krijuar kushte të mjaftueshme që planifikimi i përdorimit të gjuhës ose politika gjuhësore për zbatimin e gjuhës shqipe në RMV të bëhet në mënyrë institucionale. Ne tash kemi nevojë, siç thotë Ch. Baylon, të bëjmë *“aktivitetin me të cilin shteti ose pushteti vendos të ndërhyjë në mënyrë sistematike dhe të rregullt midis varianteve të ndryshme gjuhësore në një territor të dhënë”* (Beci, 1999, f. 14).

4. Sfidat

Ajo që është e rëndësishme në planifikimin gjuhësor të shqipes në RMV është që të dihen saktë se cilat janë sfidat që na shfaqen në këtë detyrë. Sfida e parë është njohja e themeltë e gjuhës shqipe. Duhet ta dimë se për aplikimin e drejtë të shqipes nevojitet njohja e gjuhës shqipe në disa plane: leksikore, stilistike, gramatikore e frazeologjike. Pra, duhet të njihen saktë kuptimet e leksikut të gjuhës, ndërsa në kontekstin e temës që po flasim është e patjetërsueshme edhe njohja e stileve funksionale të gjuhës, veçanërisht e stilit administrativ dhe shkencor, që është një detyrë e veçantë dhe shumë e rëndësishme, pa të cilën vështirë se mund të zbatohet shqipja në kontekstin e ri gjuhësor.

Arsyeja pse e kemi përmendur edhe njohjen e gramatikës dhe frazeologjisë është sepse shqipja jonë, që ka qenë dhe është në kontakt me gjuhët sllave (me serbishten dikur dhe me maqedonishten tash), nuk ka si mos të jetë e ndikuar në mënyrë të pavetëdijshme në ndërtimin e fjalisë, veçmas të periudhës, por edhe në përdorimin e shprehjeve idiomatike. Dhe, kjo është një kompetencë gjuhësore që vetëm gjuhëtarët me përvojë arrijnë ta përvetësojnë. Për këtë qëllim tashmë ekzistojnë edhe studime (veçanërisht prof. Qemal Murati ka punuar mjaft në këtë fushë), që sigurisht duhet kthyer në material të përdorshëm për përkthyesit (fjalor elektronikë), në mënyrë që ata të mund ta kuptojnë se, fjala bie, shqip nuk është emërtim i drejtë “Instituti për Trashëgiminë Kulturore...”, ngase nuk bëhet me parafjalën për (nga maqedonishtja “Институт за културно наследство”), por me gjinore “Instituti i Trashëgimisë Kulturore...”.

Megjithatë, meqë përdorimi zyrtar i gjuhës shqipe në RMV është i lidhur gati pandashëm me maqedonishten, kjo imponon edhe njohjen e mirë të maqedonishtes. Sado që shqiptarët në Maqedoninë e Veriut janë thujse të gjithë bilingualë, kjo nuk është e mjaftueshme edhe për detyrën që pritet.

Për këtë qëllimin sigurisht që ndihmojnë fjalorët, por një përkthyes i mirë do të duhej të kishte njohje thelbësore të maqedonishtes, pra përveç strukturës së gjuhës, ta njohë mirë edhe frymën e gjuhës maqedonase dhe kuptimet e holla që dalin nga shprehje të ndryshme. Si gjuhë sllave, një pjesë e madhe e leksikut të maqedonishtes është e përafërt me serbishten dhe për këtë arsye njohja edhe e serbishtes, së paku në përdorimin e fjalorëve, është ndihmesë në punën përkthimore të shqipes te ne.

Ndërkaq, në kushtet kur ne jemi rrugës së integritit në BE, ku anglishtja tashmë e ka zënë hapësirën më të madhe të komunikimit formal global (sot në BE të gjitha vendet anëtare e kanë anglishten gjuhë të parë të huaj dhe gati nuk ka student që mbaron një shkollë të lartë e të mos e dijë anglishten në nivel të komunikimit me shkrim – Ammon, *The Cambridge Handbook of language Policy*, 2012, f. 591), para nesh shfaqet edhe sfida e përkthimit të shumë materialeve që vijnë nga Brukseli ose që botohen nga organizata të tjera ndërkombëtare. Këtu kemi dy probleme: i pari, sepse shpesh ndodhë që materialet të përkthehen në gjuhën shqipe nga përkthimet e realizuara në maqedonisht, ndërsa përkthimi nga përkthimi është problem në vete, dhe, së dyti, problem tjetër është përkthimi i drejtpërdrejtë nga anglishtja.

Në rastin e fundit shpesh ndodhë që materiali i njëjtë në Shqipëri të jetë një tekst tjetër dhe në RMV një tekst tjetër (me terminologji tjetër). Për këtë arsye, përveç sfidës së njohjes së mirë të maqedonishtes dhe të anglishtes, në planifikimin e kontekstit të ri gjuhësor duhet të vendoset edhe parimi që materialet që janë në gjuhë të huaja të mos përkthehen nga përkthimet e realizuara maqedonisht, ndërsa kur përkthehen nga ato gjuhë, të kihet parasysh terminologjia përkatëse në tekste të tilla në Shqipëri, gjë që kërkon një bashkëpunim me institucionet përkatëse shqiptare dhe vendosje të një bashkëpunimi ndërshtetëror institucional.

Sfida më e madhe e përdorimit zyrtar të shqipes në RMV është sigurisht sanksionimi i terminologjisë, një detyrë sa e vështirë, po aq edhe e rëndësishme, sepse nëse, për shembull, “извод” është përkthyer si “certifikatë”, kjo së pari duhet të verifikohet nëpër fjalorë, por edhe në praktikën administrative në Republikën e Shqipërisë e pastaj kur të vendoset si e tillë, kjo të mos krijojë më laramani, që diku të dalë “certifikatë”, diku “vërtetim” e diku “dëftesë”. Për këtë sigurisht që ndihmojnë fjalorët elektronikë, por derisa të sanksionohet kjo terminologji, ajo është një sfidë në vete dhe një detyrë shumë delikate, për të cilën nevojitet kujdes i veçantë dhe shumëplanësh.

5. Detyrat

Nëse i kemi saktësuar ose kemi bërë një përpjekje për saktësimin e sfidave që shtrohen para nesh si shoqëri, por edhe si komunitet akademik, për planifikimin e përdorimit të gjuhës shqipe në komunikimin zyrtar të vendit, ajo që mbetet të bëhen janë të vendosen edhe synimet ose detyrat që na presin për përmbushjen e këtij qëllimi. Kur jemi këtu, duhet thënë se familja shqiptare në RMV duhet ta kuptojë se ajo është celula e parë e shqipes. Andaj përdorimi i shqipes standarde nëpër familje, pa prirje për flakjen injoruese të të folmeve lokale, është një detyrim, që fundja përkthehet në favore për fëmijët që rriten në familje të tilla, ndërsa nesër do të ketë reflektim të mirë edhe në mbarë shoqërinë shqiptare në RMV (për rolin e familjes në planifikim e gjuhës: Caldas, *The Cambridge Handbook of language Policy*, 2012, f. 351-373). Diglosia, që shfaqet në familjet tona, nuk duhet të jetë pengesë që shqiptari ta konsiderojë snobizëm komunikimin në gjuhë standarde.

Pas familjes, sigurisht rol shumë më të madh luan shkolla. Në gjendjen e re gjuhësore duhet të jetë krejt e patolerueshme që arsimtarët/profesorët të mos e përdorin drejt dhe saktë gjuhën standarde dhe kjo jo vetëm në të shkruar, por edhe në komunikimin verbal. Shkolla është “uzina”

gjuhësore e secilit intelektual të ardhshëm dhe kjo është arsyeja që askujt nuk i lejohej të jetë indiferent në komunikimin në shkollë. Shprehur ndryshe, do të thoshim se ajo se si flasim në shqip është pasqyrë e familjeve tona dhe, veçmas, e shkollave/universiteteve tona. Meqë shqipja që duhet të jetë në përdorim zyrtar është shpesh një gjuhë specifike, në kuptim të stilit gjuhësor, mendojmë se edhe sillabuset e programeve studimore duhet të përshtaten për këtë detyrë. Fjala bie, nëpër fakultetet ku studiohet gjuha shqipe, detyrimisht duhet të ketë edhe lëndë të Stilistikës së gjuhës shqipe, në mënyrë që studentët e përkthimit të mund t'i kuptojnë stilet funksionale të gjuhës.

Është lënda e Stilistikës ajo që i bën të vetëdijshëm studentët për stilet e ndryshme gjuhësore dhe, veçmas, për stilin e veprimtarisë shkencore teknike, stilin e veprimtarisë shtetërore e administrative stilin e veprimtarisë shoqërore e politike (publicistike), në të cilët do të duhet të përkthejnë dhe ndërtojnë tekste. Vetëm një student që i ka para sysh stilet e gjuhës, do ta dijë se sa janë të rëndësishëm termit përkatës në tekstet përkatëse dhe se si nuk lejohen improvizime në stilet gjegjëse gjuhësore (Xhevat Lloshi, 2004).

Megjithatë, edhe sikur të përmbushen detyrimet e familjes, të shkollës dhe të programeve studimore, as kjo nuk është e mjaftueshme pa u arritur një ndërgjegjësim i përgjithshëm shoqëror për kontekstin e ri gjuhësor. Ndërkaq, kjo mund të bëhet përmes mediave dhe shoqërisë civile. Ato, në një mënyrë, e kanë për detyrë të jenë katalizatorët që e përshpejtojnë detyrimin që shoqëria shqiptare në vendin tonë ta kuptojë mirëfilli dhe ashtu të sillet, se tashmë jemi në një gjendje të re gjuhësore dhe se përdorimi i shqipes së drejtë nga secili është një detyrim i përgjithshëm shoqëror, që e përmbush prirjen tonë përfundimtare që shqipja të jetë gjuhë e dytë zyrtare e shtetit, por pa improvizime e gabime që, hëpërhë, më shumë janë tragjike sesa komike.

Kur flasim për detyrat që na presin, duhet vënë theksin edhe te nevoja për të pasur sa më shumë fjalorë terminologjikë, sinonimikë, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh, por e rëndësishmja është që me to të krijohet një korpus elektronik gjuhësor, ku secili përkthyes, por jo vetëm, do të ketë qasje dhe mundësi që në çdo moment të mund ta gjejë fjalën përkatëse, termin e duhur ose shpjegimin e kërkuar. Në kushte të zhvillimit të këtillë teknologjik kjo edhe nuk është e vështirë, aq më shumë që shumë vepra të këtilla leksikore janë në version të shtypur, porse presin krijimin e një platforme të këtillë.

Përveç kësaj, teknologjia mundëson edhe komunikim (sipas modelit të rrjeteve sociale) që secili përkthyes, në çfarëdo institucioni që të jetë, të ketë mundësi të kërkojë ndihmë për çfarëdo termi dhe në këtë mënyrë të bashkëpunohet në ngritjen e cilësisë së gjuhës. Është e vërtetë se krijimi i këtij korpusi është një detyrë e vështirë fillimisht, por në kohën që do ta kemi atë, edhe standardizimi i gjuhës zyrtare shqipe do të jetë shumë më i lehtë. Me zhvillimin e platformave të reja të përkthimit (sipas modelit të google translate), në të ardhmen – me një korpus të tillë – puna e përkthimit edhe mund të shpejtohet. Aplikacione të tilla tashmë përdoren në OKB, por edhe në institucione të ndryshme të BE-së (një softuer të tillë në RMV e pat ofruar edhe National Democratic Institute nga SHBA), kur pas avancimit teknologjik gjuhësor të gjuhëve më të mëdha botërore, përkthimi i teksteve administrative e shoqërore-politike ka kaluar në një rutinë, që me pak ndërhyrje të përkthyesve mirë të përgatitur arrihet cilësi mjaft e lartë. Këtë të fundit jemi të bindur se mund ta ndihmojnë edhe fondet e ndryshme ndërkombëtare, por edhe përmes faktorit politik duhet të ushtrohet ndikim, që edhe buxheti i vendit të ndajë mjete për realizimin e këtij korpusi gjuhësor.

6. Burimet

Gjëja e parë që duhet vlerësuar në temën e burimeve janë kapacitetet e kuadrove profesionale që i kemi ne në Maqedoninë e Veriut, si dhe të bëjmë vlerësimin e kapaciteteve që mund të shtohen dhe të ndihmojnë në fuqizimin e kompetencës profesionale për detyrimet që na presin në gjendjen e re gjuhësore në RMV. Këtu, para së gjithash, mendojmë për programet studimore të gjuhës shqipe, veçmas të drejtmeve të përkthimit, që ekzistojnë në universitetet tona. Siç e dimë, programe studimore të drejtimit Gjuhë e letërsi shqipe kemi në Universitetin e Tetovës, në Universitetin “Shën Cirili e Metodi” dhe në Universitetin e Europës Juglindore (për shkak se janë studime private, ndjehet mungesa e studentëve).

Prej tyre vetëm në Katedrën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqiptare të Universitetit “Shën Cirili e Metodi” ka studime të akredituara të drejtimit të Përkthimit dhe interpretimit shqip-maqedonisht dhe maqedonisht-shqip (të ndara në modulën e atyre që e kanë shqipen gjuhë amtare dhe atyre që nuk e kanë gjuhë amtare), por për shkak se të diplomuarit nuk kanë arritur të gjenden mirë në tregun e punës (përkthyesit e diplomuar mund të punojnë vetëm si përkthyes dhe jo edhe si mësimdhënës, ndërsa mësimdhënësit e shqipes mund të punojnë edhe si përkthyes), ky drejtim viteve të fundit ndjen mungesë të studentëve.

Ndërkaq, në gjendjen gjuhësore që e kemi përshkruar më sipër, ne kemi nevojë të kemi shumë përkthyes të profesionalizuar. Madje, kur flasim për planifikimin e gjuhës, ne do të duhej të kemi një hulumtim që përcakton se sa është numri i nevojshëm i përkthyesve të diplomuar në këtë drejtim dhe kjo të jetë një shtytje që edhe universitetet e tjera të hapin degë të këtilla, në mënyrë që në vitet që vijnë të mund të mbulohen të gjitha dikasteret e shtetit, të cilat janë të detyruara ta përdorin e gjuhën shqipe.

Këto kuadro, natyrisht, duhet të aftësohen për zanatin e përkthimit jo vetëm në studimet e rregullta teorike, por edhe përmes trajnimeve dhe punës praktike të llojeve të ndryshme të përkthimit (me shkrim, simultan, konsektiv ose përkthime të teksteve të stileve të ndryshme të gjuhës), por edhe në përdorimin e teknikave të përkthimit e të teknologjisë për qëllime përkthimore, për çka kërkohet më shumë angazhim dhe prandaj do të pritej edhe motivim shtesë nga institucionet shtetërore, në mënyrë që nxënësit më të mirë të shkollave të mesme të kenë interes për të vijuar studimet në drejtimin e këtillë. Nëse na duhet të gjykojmë, deri tash të rinjtë/të rejtat nuk kanë ndonjë motivim të veçantë për t’u bërë përkthyes pikërisht për shkak se nuk shohin perspektivë për t’u punësuar, ndërsa – paradoksalisht – gjendja e re gjuhësore në vendin tonë implikon nevojën për qindra kuadro përkthyesish shqip-maqedonisht dhe anasjelltas.

Derisa flasim për burimet, duhet të theksojmë se të gjitha institucionet edukativo-arsimore tashmë janë në sprovë për njohjen dhe përdorimin e gjuhë shqipe. Gjendja e re gjuhësore në RMV kërkon që në të gjitha institucionet edukativo-arsimore (nga çerdhet e deri në universitete) të synohet përdorimi i gjuhës standarde shqipe pa tolerancë gabimesh, qoftë në komunikimin verbal ose me shkrim. Tashmë askush nuk ka të drejtë të arsyetohet se shqipja nuk është në përdorim zyrtar dhe kështu të mos e respektojë normën standarde të gjuhës shqipe.

Secili arsimtar, në çfarëdo cikli të arsimit dhe në çfarëdo lënde, është një burim i mësimi të gjuhës shqipe për nxënësit/studentët e tij, andaj secili e ka për detyrim që në lëndën e tij ta përdorë terminologjinë sa më të qëlluar në gjuhën shqipe, sepse ato janë terma që nguliten në gjuhën e secilit shqiptar, i cili nesër – si intelektual – nuk guxon të mos e njohë gjuhën standarde shqipe dhe terminologjinë e përgjithshme shkencore në gjuhën shqipe të lëndëve që janë mësuar gjatë shkollimit fillor dhe të mesëm, e veçmas të mos ketë deficit në terminologjinë e profesionit që e ushtron. Kjo është arsyeja që të gjitha institucionet edukativo-arsimore të ndërgjegjësohen se sa janë të rëndësishme si hallkë për përdorimin sa më të drejtë të gjuhës standarde shqipe në RMV.

Kur flasim për sistemin edukativo-arsimor, nënkuptohet se resurs shumë i rëndësishëm për mësimin/përdorimin e gjuhës shqipe janë edhe tekstet shkollore dhe veprat letrare. Tashmë nuk mund të tolerohet në asnjë mënyrë që nxënësit të kenë në dorë tekste shkollore me gabime gjuhësore, tekste të përkthyer keq ose të kenë mungesë të teksteve dhe pastaj të jenë të detyruar të përdorin tekst në gjuhë tjetër. Librat shkollorë dhe tekstet universitare janë burimi më i rëndësishëm për mësimin e shqipes në shkollë/universitet. Ndërkaq, veprat letrare, që në shkolla fillore dhe të mesme jepen si lexim i detyrueshëm, janë mjete me të cilat rritet ndjeshëm kompetenca gjuhësore, veçanërisht në rritjen e kreativitetit gjuhësor në shkrimin e shqipes.

Një burim i rëndësishëm për zbatimin e gjuhës standarde shqipe në përdorimin zyrtar janë edhe ekspertët ose profesionistët e fushës. Dhe, kur flasim për ekspertë, nuk mendojmë vetëm në gjuhëtarët shqiptarë ose në ata që kanë studiuar filologjinë shqiptare. Në të vërtetë nuk është se shqiptarët në RMV nuk kanë gjuhëtarë të mirë, por ato janë kuadro të pamjaftueshme për detyrën që pritet. Shumica e tyre janë specialistë të dialektologjisë, më pak të gjuhës standarde e të leksikologjisë dhe, aq më pak, të fushave të tjera të gjuhës.

Prandaj as nuk duhet e as nuk mund të pritët që ata të jenë njohës të të gjitha fushave të gjuhës dhe veçmas nuk mund të jenë njohës të krejt leksikut të nevojshëm për përdorimin e shqipes zyrtare në RMV. Fjala bie, nuk gjen gjuhëtar që mund ta dijë edhe terminologjinë e botanikës, të zoologjisë e të teknologjisë së informatikës, që të mund të përkthejë tekste që kanë të bëjnë me teknologji të këtillë. Kjo implikon një gamë më të gjerë të profesionistëve të fushave, që sigurisht nuk mund të gjenden vetëm në RMV, porse mund të kërkojnë edhe përtej kufijve tanë. Ndërkaq, që të eliminohet detyrimi për kuadro në kuptim të personave fizikë, kjo nënkupton që veprat e tyre të jenë në qarkullim fizik ose virtual, që do ta plotësonin këtë nevojë të përdorimit të gjuhës shqipe nëpër institucione të ndryshme shtetërore.

Edhe mediat e kanë rolin e tyre në përdorimin e gjuhës shqipe në komunikimin zyrtar në RMV. Meqë ato, në të shumtën e rasteve, janë “ushqimi” gjuhësor për shumë përdorues të shqipes, ato mund të jenë edhe burimi i saktë ose i gabuar i gjuhës shqipe. Kjo është edhe një arsye se ato duhet të jenë të ndërgjegjshme se tashmë roli i tyre nuk është vetëm informativ dhe për krijimin e opinionit, porse ato kanë rol të rëndësishëm edhe në njohjen dhe përdorimin e drejtë të shqipes në Maqedoninë e Veriut. Për ta arritur këtë, ato kanë nevojë për gjuhëtarë/redaktorë të mirë të gjuhës, si edhe për përkthyes të mirë, që të arrijnë një nivel të pritshëm dhe të dëshirueshëm të përdorimit të gjuhës shqipe në komunikimin publik.

Në kushtet kur shoqëria civile në shoqëritë tona pluraliste është një sektor i rëndësishëm që e mbulon atë zbrazëti që pushteti nuk arrin ta plotësojë ose, shpesh, është edhe korrigjues i veprimeve të pushtetit, do të ishte shumë e dobishme që shteti të ndajë mjete për OJQ-të që mund të ndihmojnë në avancimin e përdorimit të gjuhës shqipe. Projektet e tyre edukative gjuhësore sigurisht do të ndihmonin në përmirësimin e gjendjes gjuhësore të shqipes në vendin tonë.

Burimi i fundit, por jo më pak i rëndësishëm për të ndihmuar në fuqizimin e përdorimit të gjuhës shqipe në RMV, janë partitë politike. Përmes tyre mund të adresohet kërkesa për planifikimin gjuhësor, për buxhet më të madh për këtë nevojë, pastaj nevoja për kuadro, për botime, për pajisje teknologjike, për trajnime e specializime etj. Prej tyre pritët që, pavarësisht se a janë në pushtet ose në opozitë, të angazhohen të gjitha njësoj për këtë çështje. Përdorimin e drejtë të shqipes, në kuptimin zyrtar, ato duhet ta shndërrojnë në kauzë politike, që për partitë që do të jenë pjesë e pushtetit të marrë kuptim në investimin institucional për këtë qëllim.

7. Si përfundim

Krejt kjo e thamë më sipër, më shumë se zbulim i gabimeve që bëhen në përdorimin zyrtar të gjuhës shqipe, synon të ofrojë një model se si të tejkalohet ky problem dhe ne të sillemi sipas një konteksti të ri, duke e konsideruar se gjuha shqipe në RMV është zyrtare dhe duke prodhuar politika që e zbatojnë këtë gjendje. Pasi që kemi bërë shpjegime terminologjike të termave kryesorë që përdoren në këtë artikull, si dhe pasi që e kemi përshkruar kontekstin e ri gjuhësor në RMV pas miratimit, më 11 janar 2018, të Ligjit për përdorimin e gjuhëve (gjuhës shqipe), jemi përpjekur ta konkretizojmë se cilat janë sfidat me të cilat ne përballemi, cilat janë detyrat që shtrohen para nesh dhe cilat janë burimet me të cilat ne mund ta bëjmë planifikimin e ri gjuhësor në vendin tonë.

Ne jemi të bindur se në një kumtesë si kjo nuk mund të përmbliidhen të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me këtë planifikim gjuhësor, madje as nuk kemi pretendime shteruese, por jemi të sigurt se kjo është rruga që duhet të ndiqet për të pasur një gjendje të volitshme gjuhësore. Ndonëse receta për këtë temë ka plot dhe nuk ka nevojë që ne të shpikim diçka të pathënë, megjithatë kontributi ynë është në njohjen specifike të situatës sonë gjuhësore dhe përshtatjen e mekanizmave tashmë të zbatuar për nevojat tona vendore. Sidoqoftë, le të jetë ky artikull një kontribut shtesë në këtë drejtim, me shpresë se koha që vjen do të sjellë edhe studime të tjera më me vlerë në këtë temë.

Referencat

- [1]. Beci, B. (1999). *Probleme të politikës gjuhësore dhe të planifikimit gjuhësor në Shqipëri*, Pejë, “Dukagjini”
- [2]. Byron, J. (2012). *Përzgjedhje midis alternativash në standardizimin e gjuhës dhe shkrime të tjera*, Tiranë, “Dituria”
- [3]. Ismajli, R. (1998). *Në gjuhë dhe për gjuhë*, Pejë, “Dukagjini”
- [4]. Jernudd, B. and Nekvapil J. (2012). *The Cambridge Handbook of language Policy*, UK, “Cambridge University Press”
- [5]. Lloshi, Xh. (2001). *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, “Shtëpia Botuese e Librit Universitar”
- [6]. Radovanović, M. (2004). *Planiranje jezika i drugi spisi*, Novi Sad, “Izdavačka knjižarnica Zoran Stojanovića Sremski Karlovci”
- [7]. Siguan M. (2004), *Jezici u Evropi*, Zagreb, “Školska knjiga”
- [8]. *АСНОМ и Македонската држава* (зборник на трудови...), 2014, МАНУ, Скопје